



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.9, datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË  
LEJES/AUTORIZIMIT, SUBJEKTIT “A.N.K” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale me Nr.serie:00007, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.49, datë 22.02.2017, subjektit “A.N.K” sh.p.k, me vendndodhje, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 472225.3; Y= 4616985.7; Z=11 m.m.n.d;

- Prurja mesatare :  $Q_{mes} = 20 \text{ l/s}$
- Sasia e ujit në përdorim :  $Q = 4 \text{ l/s}$
- Qëllimi i përdorimit : Industrial (Larje Inertesh)
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në Shtratin e lumit Mat

3. Burimi ujqor të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU MAT**  
**GJERGJ PRENDI**



The stamp is circular with the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE-S" at the top, "KESHILLI I BASENIT UJQOR-MAT" around the bottom, and "MAT" in the center. It features the coat of arms of Albania. A blue ink signature is written over the stamp.